David R. Hernandez dhe Dhimitër Çondi

Forumi romak në Butrint (Epirus) dhe zhvillimi i tij nga periudha helenistike në atë mesjetare*

* Artikulli është botuar për herë të parë në (2008) *Journal of Roman Archeology* 21, 'The Roman forum at Butrint (Epirus) and its development from Hellenistic to medieval times', 275-92.

Butrinti (*Buthrotum, Bouthrotos*), shtrihet në një kep me sipërfaqe 16 ha në grykë të një lagune që lidhet me detin Jon nëpërmjet një vije uji të lundrueshme, kanalit të Vivarit (Fig. 1). Me një pozitë gjeografike të favorshme në bregdetin e thyer epirot, Butrinti lulëzoi si një port mes rrugëve detare tregtare që lidhnin lindjen me perëndimin. Gërmimet e para në qendrën urbane të Butrintit filluan në 1928 nga misioni arkeologjik italian, nën drejtimin e L.M. Ugolinit, që rezultuan me zbulimin e teatrit helenistik dhe monumenteve të tjera antike që rrethonin sanktuarin e Asklepit.[1] Këto gërmime, të financuara nga qeveria italiane, synonin të ngrinin lart një lidhje mes Romës dhe Butrintit antik duke u bazuar në vizitën legjendare të Eneas në këtë të fundit, që përshkruhet si një 'parva Troja' në veprën Eneida dhe në kulturën materiale, e cila lidhej me koloninë romake të *Buthrotum*.[2] Një nga objektivat tona kryesore ishte të rishikonim arkeologjinë e qendrës urbane, pas mëse 70 vjet gërmimesh jo të vazhdueshme, me anë të rigjetjes së një vazhdimësie diakronike depozitash stratigrafike për të sqaruar fazat e urbanizimit helenistik, romak dhe mesjetar. Për arsye se pak dihej mbi arkeologjinë dhe topografinë e kolonisë romake, ne menduam ta lokalizonim vendndodhjen e forumit romak, të cilin Projekti Butrinti e mendonte se ndodhej përballë godinës me tre ambiente pranë teatrit (Fig. 2).[3] Gërmimet e viteve 2004-7 dhanë një material arkeologjik të konsiderueshëm. Ndonëse rezultatet janë ende të përkohshme, ato përfshijnë një rishikim të rëndësishëm të kronologjisë dhe topografisë të Butrintit helenistik dhe romak. Pjesa e parë e këtij artikulli rishqyrton monumentet helenistike të qendrës urbane në dritën e të dhënave më të fundit arkeologjike. Ne propozojmë një skemë të re për fazat dhe marrim në konsideratë faktorët historikë që mund të kenë kontribuar në

[1] Ugolini 1935; 1937; 1942; 2003.
[2] Verg., *Aeneid* 3.292-505; Ov., *Metamorphoses* 13.719-23; Dion. Hal., *Ant. Rom.* 1.51. Shih: Hansen në këtë volum; Gilkes 2003a: 15-8; Bowden 2003: 28. Mbi gjetjet e Ugolinit që lidhen me koloninë romake shih: Bergemann 1998.
[3] Hogdes *et al.* 1997: 215-6; Martin 2004: 86-7. Për më shumë mbi Butrintin shih: Hodges 2006.

Fig. 1 Butrinti dhe rajoni ku ai shtrihet (Butrint Foundation)

transformimin urban të Butrintit helenistik. Pjesa e dytë eksploron arkeologjinë dhe topografinë e forumit romak dhe ndërtesave që lidhen me të. Ne diskutojmë ndërtimin e forumit në lidhje me kolloninë romake dhe gjurmojmë zhvillimin e tij deri në momentin e braktisjes përfundimtare.

Fig. 2 Ndërtesa me tre ambiente (Butrint Foundation)

Topografia dhe kronologjia e sanktuarit helenistik të Asklepit (Fig. 3)

Teatri mendohet se daton në shek. IV ose III p.Kr.[4] Duke pasuar Ugolinin, studiuesit i kanë përcaktuar një datim të hershëm, gjithashtu, tempullit mbi teatër (midis shek. IV dhe III p.Kr.), bazuar në teknikën unike të ndërtimit të tij.[5] Tempulli është vendosur mbi një temenos të hapur në shpatin shkëmbor të akropolit.[6] Nisur nga fakti se kavea e sipërme përputhet me temenosin, teatri mendohet të jetë ndërtuar ose pas ose njëkohësisht me të.[7] Stilobati i tempullit i përbërë nga blloqe guri të latuar, të cilët lidhen me anë të ganxhave prej plumbi, zbukurohet përgjatë rradhës më të poshtme me gjethe akanthi në formë trekëndore.[8] Teknika e ndërtimit është e njëjtë me atë të stoas jugore (Ndërtesa 2.A), e zbuluar së fundi, dhe paraqet një tip të veçantë që takohet shumë rrallë në Butrint apo më gjerë në Epir. Qeramika e gjetur në depozitat stratigrafike poshtë gurëve të themelit të stoas jugore (shih më poshtë) dëshmon

[4] Ugolini 1937: 135, e daton teatrin si të 'periodo classico' duke iu referuar shek. IV. p.Kr. Budina 1988: 71 dhe Wilkes 2003: 166 propozojnë si datim shek. III. p.Kr.
[5] Tempulli u gërmua nga Ugolini (Ugolini 1937: 122-3, fig. 71-72). Budina 1988: 61, e daton tempullin në shek. IV p.Kr., ndërsa Baçe 1984: 24-5, e daton në shek. III p.Kr.
[6] Mbi vendndodhjen dhe arkitekturën e tempullit shih: Pani 1988: 31, fig. 14.
[7] Wilkes 2003: 166-7.
[8] Pani 1988: 32; Budina 1988: 61.



Fig. 3 Rikonstruksion i Butrintit helenistik në shek. II p.Kr. (Butrint Foundation)

se ndërtesa nuk mund të datojë më herët se shek. II p.Kr. E parë nën këtë prizëm, ka të ngjarë që tempulli mbi teatër daton në shek. II p.Kr. Ky stil i njëjtë murature dhe kjo teknikë ndërtimi shihet në të dy pjesët e teatrit.[9] Rradha e poshtme e kaveas nën ndenjëset është e njëjtë me arkitekturën e stoas jugore.[10] *Spolia*-t në themelet e *scanea frons* romake janë identike me muraturën e stoas jugore: vrimat e kunjave si dhe zbukurimet me gjethe akanthi trekëndore janë identike në formë.[11] Tipi i veçantë i muraturës sugjeron se *spolia*-t vijnë nga materialet me të cilat u ndërtua fillimisht teatri. Bazuar në datimin e stoas jugore, ne propozojmë fillimin e shek. II p.Kr. si kohë e mundshme e ndërtimit të teatrit.

Ky datim së fundi është konkretizuar nga datimi i mbishkrimeve greke të gdhendura në teatër.[12] Në rradhën e dytë të ndenjëseve, një mbishkrim dedikues përkujton ndërtimin e teatrit: 'nga të ardhurat publike të perëndisë [Asklepit]'.[13] P. Cabanes dhe F. Drini tregojnë se mbishkrimi i përket periudhës së Lidhjes Epirote (232-168 p.Kr.) duke argumentuar se ai daton në shek. II p.Kr. por më herët se viti 168 p.Kr.[14] Pesëdhjetë e gjashtë mbishkrime në parodosin perëndimor dhe diazomë përbëhen nga akte ligjore të çlirimit nga skllavëria duke renditur emrat e skllevërve të liruar, të magistrave dhe të priftërinjve të Asklepit.[15] Të gjithë mbishkrimet e lirimit të skllevërve të gdhendur në teatër datojnë pas vitit 163 p.Kr, atëhere kur *Buthrotos* fitoi autonominë dhe u bë kryeqendër e koinonit të prasaibëve dhe kontrollonte një fushë të madhe pjellore që shtrihej deri në Konispol.[16] Një datim i tillë i teatrit mbështetet gjithashtu dhe nga gërmimet në Finiq, kryeqendra e Kaonisë,[17] ku depozitat stratigrafike tregojnë se arkitektura më e hershme e teatrit daton në fund të shek. III p.Kr. ose në shek. II p.Kr.[18]

[9] Budina 1988: 61.
[10] Zbukurimet me gjethe akanthi nën ndenjëset u ripunuan në koka luanësh. Shih: Ugolini 2003: 90, fig. 6.31, 6.34
[11] Mbi fotot e *scanea frons* që paraqesin këtë muraturë shih: Ugolini 1935: 85; 2003: 96, fig. 6.53-56.
[12] Cabanes dhe Drini 2007: 71-125; 289-316. Mbi mbishkrimet e teatrit gjithashtu shih: Bozhori dhe Budina 1966: 143-91; Cabanes 1974: 105-209; Cabanes 1976: 386-477.
[13] Ugolini 2003: 89; Cabanes dhe Drini 2007: 71-2, nr.7.
[14] Cabanes dhe Drini 2007: 71-2, 289. Duke ndërtuar një kronologji absolute dhe relative për mbishkrimet greke të *Buthrotos*, bazuar në magistrat dhe priftërinjtë e emëruar, Cabanes dhe Drini demonstrojnë se mbishkrimi dedikues në teatër ndoshta daton në (fillim) të shek. II p.Kr. Mbi Republikën Epirote shih: Hammond 1967: 595-635; Cabanes 1976: 198-396.
[15] Cabanes dhe Drini 2007: 79-125. Disa mbishkrime përfshijnë emrat e priftërinjve të Zeus Soter-it.
[16] Data e saktë mbi pavarësinë e koinonit të prasaibëve tani mendohet të jetë diku mes viteve 163 dhe 158 p.Kr.: Drini 1984: 104-6; Cabanes dhe Drini 2007: 64, 290; Cabanes 1996: 378-9, ka preferuar më parë një datë mes viteve 170 dhe 168 p.Kr.
[17] Mbi një sintezë të rezultateve të gërmimeve në Butrint dhe Finiq shih: Giorgi *et al.* 2007.
[18] Villicich 2005: 67-8; Villicich 2007: 71; Giannotti 2005: 82-4. Ndonëse arkitektura helenistike e teatrit të Finiqit daton në shek. III/II p.Kr., arkeologët besojnë se duhet të ketë pasur një fazë më të hershme të tij të ndërtuar nga Pirro në fillim të shek. III p.Kr.

Stoa e gjatë, e cila daton në shek. IV ose III p.Kr., u cungua në pjesën perëndimore të saj gjatë ndërtimit të teatrit.[19] G. Pani sugjeron se godina kishte shërbyer si një *abaton* për inkubacionin ritual ku adhuruesve iu shfaqeshin vegime nga Asklepi para se të fillonte trajtimi.[20] Faltorja e Askplepit, e cila daton në shek. IV ose III p.Kr., merr formën e një tempulli *in antis* me celën dhe pronaosin.[21] Pjesa e pasme e faltores përbëhet nga një *favissa*, një dhomë e ndërtuar përreth një shpelle të vogël natyrore, e cila ishte e mbushur me rreth 340 votiva për nder të Askplepit.[22] *Favissa*, të cilën Ugolini mendoi se datonte në periudhën prehistorike, ndoshta shërbente si burim kryesor i ujit shërues për sanktuarin.[23] Investigimi ynë i burimit të shenjtë, në vitin 2006, nxorri në dritë një çarje nëntokësore në shtratin e shkëmbit që duket se kalonte përgjatë rrëzës jugore të shpatit të akropolit. Ka mundesi që *favissa* të derdhej në ujin e kësaj çarje, duke formuar në këtë mënyrë, ndoshta, bazën mbi të cilën u zhvillua fillimisht sanktuari i Asklepit.

Kompleksi helenistik: Të dhëna arkeologjike

Stoa Veriore (Ndërtesa 1.A) (Fig. 3-4)

Në rrëzë të shpatit jugor të akropolit, gërmimet në zonën I nxorrën në dritë themelet e anës veriore të Ndërtesës 1.A. Anët jugore dhe perëndimore të saj, të ndërtuara me blloqe guri të latuar e të lidhur me ganxha prej plumbi, ishin zbuluan nga gërmimet e mëparshme.[24]



Fig. 4 Faza helenistike e kompleksit të Ndërtesës me tre ambiente (zonat I-XIV) (Butrint Foundation)

[19] Budina 1988: 58; Pani 2001: 18, nr.16; Wilkes 2003: 166-7, fig. 6.35-40. Godina u gërmua për herë të parë nga Ugolini. Shih: Ugolini 1937: 123-5, fig. 73.
[20] Pani 2001: 19; Melfi 2007: 23-4.
[21] Ugolini 1942: 104-8. Tempulli zakonisht është datuar në shek. IV p.Kr.: Pani 2001: 16; Wilkes 2003: 166; Martin 2004: 82. Mbi një datim në shek. III p.Kr. shih: Budina 1988: 63 dhe Baçe 1984: 21. Melfi 2007: 22-3, e interpreton ndërtesën si një thesar. Për shkak se pozicioni dhe forma e godinës u përcaktuan nga një burim, i cili u integrua në godinë si një favissa, ne mbështesim idenë se godina ka luajtur rolin e një faltoreje.
[22] Ugolini 1937: 152-7; 1942: 91-146.
[23] Ugolini 1942: 100.
[24] Zona u gërmua për herë të parë nga S. Islami në 1982 dhe me vonë (1990-1) nga Dh. Çondi. Shumë nga të dhënat e këtyre gërmimeve kanë humbur si pasojë e vjedhjeve të fondeve gjatë trazirave të vitit 1997 në Shqipëri. Mbi një përshkrim të shkurtër të gërmimeve shih: Çondi 1990: 264-5.

Të tre këto mure nxjerrin në pah formën dhe përmasat e godinës (25.5 x 4.5 m), të cilën ne e identifikojmë si një stoa. Depozitat e ndërtimit të saj dhanë 5 monedha, nga të cilat një drahme e prerë në Korkyrë përcakton vitin 229 p.Kr. si një *terminus post quem*. Nisur nga qeramika e gjetur në këto depozita ndërtimi i takon shek. III p.Kr. Ndërtesa 1.A me sa duket daton rreth fundit të shek. III/fillimit të shek. II p.Kr.

Stoa jugore (Ndërtesa 2.A) (Fig. 3, 5-6)

Gërmimet në zonën XV zbuluan stilobatin e Ndërtesës 2.A me gjatësi 6 m, dy shkallë blloqesh guri gëlqeror të vendosur mbi themele, gurët e të cilëve lidheshin me njëri tjetrin me ganxha plumbi. Katër gjurmë rrethore dëshmojnë për praninë e kolonave, ku secila prej tyre përmbante një vrimë qendrore si dhe një kanal të vogël në të cilin derdhej plumbi. Kolonat kishin një diametër prej 0.58 m dhe ishin të baraslarguara në një distancë prej 1.81m nga njëra tjetra. Për shkak se diametri i kolonave si dhe masa e forma e vrimave qendrore janë identike me ato të fragmenteve të kolonave prej graniti të lokalizuara tashmë pranë shatërvanit romak, është e mundur që i njëjti tip i kolonave prej graniti të qëndronin mbi stilobatin e Ndërtesës 2.A. Faqet veriore të të dy shkallëve janë zbukuruar me motive gjethesh akanthi. Këto të fundit ndahen në intervale (prej 0.90 m) që përputhen saktësisht me hapësirën e kolonave. Forma e Ndërtesës 2.A së bashku me stilobatin e saj, sugjeron se ajo ka funksionuar si stoa. Qeramika e gjetur nën gurët e themelit përmbante importe nga Kampania dhe Megara që e datojnë ndërtesën në shek. II p.Kr.

Fig. 5 Pamje e cepit J/P të forumit romak (zona XV) (Butrint Foundation)



Fig. 6 Planimetria e cepit J/P të forumit romak (zona XV) (Butrint Foundation)

Ndërtesa 3.A dhe një ulluk (Fig. 4)

Gërmimet në zonën IX, nxorrën në dritë një ulluk të hapur, me gjatësi 12 m, i cili përbëhej nga rrasa guri të shtruara me drejtim tatëposhtë. Pranë faqes perëndimore të ullukut ndodhej një linjë muri me gurë të latuar (Ndërtesa 3.A) me gjatësi 10.4 m dhe lartësi të ruajtur prej 4 rreshtash. Teknika e tij është e ngjashme me atë të Ndërtesës 1.A (stoa veriore). Ulluku dhe Ndërtesa 3.A shfaqen të jenë një ndërtim i pandarë dhe bashkëkohor me stoan veriore (Ndërtesa 1.A) që daton në fundin e shek. III ose ndoshta në shek. II p.Kr. Ky ulluk me sa duket shërbente për largimin e ujit, i cili rridhte nga akropoli, jashtë stoas veriore.

Burimi i shenjtë (Fig. 4, 7)

Pranë stoas veriore, një shpellë (4 m e thellë) e favorizuar nga një çarje në shkëmb, krijonte një burim natyror.[25] Për shkak të murit të tij të pasëm (me blloqe guri të latuar) që lidhet me stoan e gjatë, e cila daton para teatrit, burimi duhet të jetë përdor të paktën që prej shek. III p.Kr. duke shërbyer si pjesë e sanktuarit të Asklepit. Në periudhën romake burimi u zbukurua me një parapet mermeri, i cili vendosej mes dy blloqeve të mëdhenj gëlqerorë. Shenja të thella përgjatë pjesës së sipërme të parapetit prej mermeri ishin formuar nga litarët që nxirrnin ujë nga pusi. Rindërtimi romak përdor gjithashtu *spolia* në të cilat vihen re gjurmë litari, duke sugjeruar se blloku ka qenë pjesë e parapetit helenistik.

[25] Burimi u zbulua gjatë gërmimeve të vitit 1982; Budina 1988: 58-60, tab. 9.

Fig. 7 Burimi i shenjtë, dhoma trekëndore dhe shkallët drejt akropolit (zonat VII dhe VIII) (Butrint Foundation)

Topografia dhe periodizimi i Butrinit helenistik (Fig. 3)

Bazuar në të dhënat e përvijëzuara më lart, ne propozojmë këto faza për qendrën urbane helenistike. Faza më e hershme (fundi i shek. IV ose shek. III p.Kr.) përfshinte faltoren e Asklepit, stoan e gjatë dhe burimin e shenjtë (ndoshta edhe prytaneionin).[26] Zona ndërmjet faltores së Asklepit dhe burimit të shenjtë mund të ketë shërbyer si temenosi i Asklepit. Me përjashtim të disa fragmenteve qeramike që datonin në shek. V p.Kr. gjatë gërmimit tonë nuk u zbulua asnjë gjurmë që mund të lidhej me një fazë kaq të hershme.[27]

Qendra urbane pësoi ndryshime të konsiderueshme në shek. II p.Kr. me ndërtimin e teatrit, të tempullit mbi teatër si dhe të Ndërtesës 1.A, 2.A, dhe 3.A. Ritualet shëruese mund të jenë zhvilluar në *abaton* (stoa e gjatë) dhe në ndërtesa të tjera (p.sh Ndërtesa 3.A) që rrethonin një hapësirë të kufizuar, e cila të çonte drejt burimit. Në jug të kësaj hapësire të kufizuar, shtrihen dy rreshta themelesh paralele (por krejtësisht të ndryshëm), njëri prej të cilëve mund të ketë qenë pjesë e një godine helenistike.[28] Qendra urbane gjithashtu duket se u zgjerua në drejtim të lindjes. Dy stoat e reja (Ndërtesa 1.A dhe 2.A) përcaktonin një hapësirë, e cila ka të ngjarë se ishte agoraja (me përmasa 26.5 mV/J x 40-60 m L/P); kjo jo vetëm për faktin se hapësira në fjalë më pas u shndërrua në forumin e qytetit të periudhës romake. Zhvillimi i Butrintit helenistik në shek. II p.Kr. pasqyron një program urbanizimi, i cili lindi nga një sanktuar.

[26] Prytanioni u gërmua nga Budina dhe mbetet i pabotuar. Pani 2001: 21 e daton fazën më të hershme të tij në shek. III p.Kr.

[27] Ndonëse ne gërmuam deri në 1 m thellësi nën nivelin e ujit nuk arritëm të takonim depozitat natyrore në pjesën më të madhe të kuadrateve të hapur (përveç zonave I-III).

[28] Ndërtesa nuk është botuar. Dy themelet paralele nuk kanë të njëjtën muraturë dhe duket se nuk janë të njëkohshëm. Linja jugore e themeleve, e cila ndoshta është helenistike, i ka të dy faqet e drejta dhe bën një kthesë në fundin perëndimor të godinës. Ndërsa linja veriore, e cila ka të punuar vetëm faqen jugore, mund të ketë shërbyer si një rrugë me kolonada në periudhën romake, siç është sugjeruar dhe nga Pani 2001: 25.

Butrinti dhe Epiri helenistik: gjykime historike

Lulëzimi i Butrintit në shek. II p.Kr., i pasqyruar në zhvillimet arkitekturore dhe mbizotërimin e qeramikës së shekujve II dhe I p.Kr., mund të ketë qenë i lidhur me një ndryshim të papritur të lëvizjeve të tregëtisë detare epirote. Në shek. III p.Kr një rrjet tregëtar jo-lokal, i cili kalonte nga Egjeu lindor përmes Epirit drejt Italisë dhe Siçilisë,[29] solli përfitime për qytetet bregdetare të Epirit, veçanërisht për ata në jug përreth gjirit të Ambrakisë, i cili shpesh ndodhej nën kontrollin e koinonit të fuqishëm të Molosëve. Kjo prirje e tregëtisë ndryshoi befas në vitin 170 p.Kr. me shpërbërjen e Lidhjes Epirote, gjatë Luftës së Tretë Maqedonase, kur kaonët dhe thesprotët u lidhën me Romën, ndërsa molosët bënë aleancë me Maqedoninë.[30] Pas disfatës së maqedonasve në Pidna, një *senatus consultum* i vitit 167 p.Kr. urdhëroi konsullin fitimtar, Emil Paul, të plaçkiste mbretërinë e molosëve.[31] Ai skllavëroi rreth 150.000 molosë dhe rrafshoi në themel 70 qytete.[32]

Ndikimi që pati shkatërrimi i molosëve në zhvillimin ekonomik të Epirit të Veriut, në përgjithësi, nuk është trajtuar si duhet.[33] N.L.G. Hammond me të drejtë nxirrte në pah se 'zona që përfitoi më shumë nga ngulimet romake ishte Epiri i Veriut'.[34] Në të vërtetë, drejtuesi i fraksionit pro-romak të Kaonisë, Karops, mund ta ketë udhëhequr politikën romake drejt plaçkitjes së Molosisë.[35] Shfarosja e molosëve duhet të ketë sjellë një zhvendosje të tregëtisë, në favor të qyteteve bregdetare të Epirit të Veriut. Pas kolapsit të eksporteve molose, dhe ndoshta eleminimit të rivalit të tyre ekonomik më të madh, Butrinti dhe Korkyra duhet të kenë përjetuar një rritje të numrit të anijeve në portet e tyre si dhe të kërkesës për të mira materiale. Në vitin 1977, 104 mbishkrime mbi çlirimin nga skllavëria, u gjetën të ripërdorura si *spolia* në Kullën me Mbishkrime të Butrintit. Të gjithë mbishkrimet, me përjashtim të katër prej tyre, datojnë pas vitit 163 p.Kr.[36] Shumë prej tyre dokumentojnë lirimin e skllevërve nga individë (ndryshe nga grupet vjetore të dokumentuar në mbishkrimet e teatrit). Kjo gjë dëshmon për rritjen e zotërimit të skllevërve në këtë periudhë. Katalogu i 219 mbishkrimeve në gjuhën greke të Butrintit, i përgatitur nga P. Cabanes dhe F. Drini tregon se mbishkrimet më të hershme datojnë në çerekun e parë të shek. II p.Kr.dhe se shumica e tyre i përket viteve 160 dhe 100 p.Kr.[37]

Rritja e ndjeshme e numrit të akteve të çlirimit nga skllavëria në gjysmën e dytë të shek. II p.Kr. sinjalizon pasurimin e qytetit si edhe një shtim të konsiderueshëm të popullsisë së skllavëruar.[38] Si aleatë të romakëve, koinonet e Epirit të Veriut, përfshirë këtu dhe prasaibët me qendër në Butrint, mund të kenë siguruar skllevër molosë ose duke i blerë ose duke i ndarë si plaçkë lufte. Pas 167 p.Kr. rritja e tregëtisë detare mund të ketë kontribuar në prosperitetin e mëtejshëm, duke sjellë rimodelimin e sanktuarit të Asklepit dhe ndërtimin e agorasë.

[29] Hammond 1967: 579-80, 587-90.
[30] Disa qytete thesprote gjithashtu u lidhën me Maqedoninë, shih: Hammond 1967: 628; Cabanes 1996: 378-9.
[31] Polyb. 30.15 (është burimi kryesor mbi këtë ngjarje); Livy 45.34.5; Strabo 7.7.3; Plut., *Paul.* 29.4.
[32] Strabo (7.7.9) e përshkruan Epirin si 'të rrënuar'. Mbi shkallën e shkatërrimit shih: Hammond 1967: 634-5, 686-90. Studimet e fundit kanë treguar se, ndonëse Epiri Qendror dhe Jugor mund të mos jenë 'rrënuar' pas plaçkitjes së Molosisë, zona u varfërua relativisht deri në kohën e Augustit, duke i munguar shumë nga qendrat urbane formale të mëparshme: Isager 2001: 17-27; Gravani 2007:101-22; Riginos 2007: 163-73.
[33] Ziolkowski 1986: 69-80, i konsideron implikimet ekonomike nga këndvështrimi i Romës, duke argumentuar se shkaku kryesor për shkatërrimin e Molosisë ishte përvetësimi i skllevërve; ai e konsideron këtë ngjarje si 'operacionin më të madh të gjuetisë së skllevërve në historinë e Romës'.
[34] Hammond 1967: 688.
[35] Scullard 1945: 60-4; Cabanes 1976: 15, 304-5.
[36] Cabanes dhe Drini 2007: 59, 125-72. Katër mbishkrime nga kulla datojnë në periudhën e Republikës Epirote (232-168 p.Kr.), ndoshta në fillim të shek. II p Kr. Gjithashtu shih: Drini dhe Budina 1981; Drini 1984.
[37] Cabanes dhe Drini 2007: 289, 316.
[38] Cabanes 1976: 466.

Kolonia romake e *Buthrotum* dhe zbulimi i forumit (Fig. 8)

Pas vrasjes së Jul Çezarit, Ciceroni udhëhoqi një përpjekje të fuqishme për të përfunduar dekretin e Çezarit që bënte thirrje për kolonizimin romak të *Buthrotum*-it; kjo evidentohet nga 26 letrat e shkruara në periudhën prill-korrik të vitit 44 p.Kr.[39] Ciceroni synonte të mbronte interesat e T. Pompon Atikut, i cili zotëronte një vilë dhe prona të mëdha toke në *Buthrotum.*[40] *Buthrotum*-i u planifikua të priste një koloni pasi 'gjoja' qyteti nuk i plotësonte detyrimet e tij në taksa, por në fakt ai ishte pjesë e një programi kolonizues më të madh që synonte qytetet bregdetare të Ballkanit Perëndimor.[41] Si ekzekutues i dekreteve dhe planeve të Çezarit, Antoni kishte më së shumti nën kontroll sipërmarrjen kolonizuese të *Buthrotum*-it. Në tre letra, Ciceroni me padurim kërkonte të dinte mbi përfundimin e kolonëve që ishin dërguar për në *Buthrotum* nën *praetorio*-n e emëruar L. Plancus.[42] Ndonëse shpresonte t'i shpërndante këta kolonë gjetkë nëpër Epir, ka mundësi që Ciceroni të ketë dështuar dhe këta të ardhur e kolonizuan *Buthrotum*-in në vitin 44 p.Kr.[43] Për të përkujtuar themelimin e kolonisë së re, *Buthrotum* preu monedha, ku një seri kishte legjendën COL(onia) I(ulia) BVT(hrotum).[44] Pas betejës së Aktiumit, Augusti rithemeloi koloninë, megjithëse mbetet e paqartë nëse ky rithemelim i tij ishte thjesht një dhënie formale e statusit kolonial apo përfshinte përzierjen e kolonëve të ardhur më pas. Dy seri monedhash që përkujtonin rithemelimin e Augustit kishin në faqe portretin e Augustit dhe legjendën C(olonia) A(ugusta) BVT(hrotum), ndërsa në shpinë një imazh të akuaduktit të Butrintit.[45]



Fig. 8 Rikonstruksion i qendrës së Butrintit romak në shek. II m.Kr. (Butrint Foundation)

[39] Cic., *Atticus* 14.10-12, 14, 17, 19- 20; 15.2, 4, 12, 14-15, 18-20, 29; 16.1-4, 16A-F.
[40] Mbi Atikun dhe *Buthrotum* shih: Deniaux 1975: 283-96; 1987: 247-54. Mbi një lidhje të mundshme të vilës së Atikut me Diaporitin shih: Bowden dhe Përzhita 2004: 413-33.
[41] Cic., *Atticus* 16.16A. Mbi një diskutim të programit kolonizues të Çezarit dhe Augustit në Greqinë Perëndimore dhe Epirin shih: Rizakis 1997: 15-36.
[42] Cic., *Atticus* 15.29; 16.1, 4.
[43] Deniaux 1987: 252. Letra pajtuese e Ciceronit drejtuar Atikut (16.3) tregon, në mënyrë absolute, se Atiku nuk ia arriti qëllimit të tij dhe se nuk qe në gjendje të ndalonte kolonizimin.
[44] Burnett *et al.* 1992: 276, nr. 1379.
[45] Burnett *et al.* 1992: 277, nr. 1381-82, 1387-93, e identifikojnë imazhin e 4 këmbëve me harqe në monedha si këmbë të një 'ure', por meqënëse monumenti është me një urë me këmbë me dy rreshta, ka mundësi që kjo paraqet akuaduktin, siç ka propozuar edhe Ugolini 1942: 46, 233.

Si shenjë dalluese e patronazhit perandorak dhe e realizuar nën kompetencën e inxhinjerëve të aftë ushtarakë romakë, ndërtimi i akuaduktit ndoshta ishte vepër bamirësie e Augustit.[46] Seria e këmbëve të akuaduktit në fushë Vrinë dhe në brendësi të Butrintit, dëshmojnë se ai kapërcente kanalin e Vivarit dhe furnizonte me ujë nymfeun në skajin lindor të qytetit. Nga nymfeu, këmbët e akuaduktit shtrihen drejt Portës me Kulla ku ato kthehen drejt perëndimit për të përfunduar tek muret rrethuese helenistike.[47] Nga kjo pikë, akuadukti, i cili duket se i mbështetej murit fortifikues kthehej nga perëndimi drejt qendrës urbane. Çmontimi i Kullës me Mbishkrime nxorri në dritë themelet e këmbëve të akuaduktit, duke konfirmuar kështu vazhdimin e tij përgjatë murit fortifikues.[48]

Zbulimi i dyshemesë dhe cepit V/P të forumit në vitin 2005 tregoi se ndërtesa me tre ambiente ngrihej përballë anës veriore të forumit.[49] Duke e marrë si të mirëqenë se akuadukti shtrihej nga Kulla me Mbishkrime e deri tek kompleksi i banjave në pjesën përpara teatrit, ne hamendësojmë se forumi kishte orientim L/P dhe se muri rrethues helenistik në këtë zonë u prish për t'i hapur vend ndërtesave romake që rradhiteshin përgjatë anës jugore të forumit. Mbi këtë hipotezë, në vitin 2007 ne zbuluam cepin J/P të forumit (zonën XV). Zbulimi i kufirit jugor të forumit dëshmon se ai shtrihej me orientimin L/P dhe mbështet idenë tonë se akuadukti kalonte nëpër strukturat jugore të forumit. Shtrirja topografike e qendrës urbane sugjeron se akuadukti kapërcente hyrjen kryesore jugore të forumit ku ndoshta arrinte dhe *cardo maximus*. Më në jug të Butrintit, në Nikopojë, një pjesë e akuaduktit kalon mbi murin fortifikues dhe Portën Perëndimore, ku aty akuadukti e kalonte *decumanus maximus*.[50] Siç thekson K. Zachos, një vendosje e ngjashme ka ekzistuar në Romë, ku *Aqua Claudia* dhe *Anio Novus* kapërcenin Porta Maggiore-n. Në Butrint, zbulimet gjeomagnetike dhe gërmimet në lagjen periferike romake të fushë Vrinës kanë treguar se ndarja në *centuration* dhe *actus* i vendbanimit të organizuar romak jashtë mureve rrethues të qytetit u përcaktua nga drejtimi i akuaduktit.[51] Në sajë të pasigurisë së datimit të akuaduktit në qendrën urbane, mbetet e panjohur nëse ndërtimi dhe topografia e forumit dhe qendrës urbane u përcaktuan pjesërisht nga vija e akuaduktit.

Dyshemeja e forumit (Fig. 5, 8-9)

Gërmimet zbuluan *in situ* dyshemenë e forumit romak të shtruar me pllaka gëlqerore të bardha. Një kanal i ndërtuar me gurë gëlqerorë përreth perimetrit të dyshemesë, duke shërbyer si pjesë e një sistemi kullimi për godinat që rrethonin forumin, ishte pjesë e pandarë e forumit; në anën veriore, jugore dhe perëndimore, dy shkallë mermeri ngriheshin nga dyshemeja e forumit. Gjerësia (V/J) e forumit është 20.1 m; ndërsa gjatësia (L/P) mund të përllogaritet nga rrënojat e ndërtesës lindore (gërmuar në 2004-5 nën drejtimin e N. Cekës dhe Dh. Çondit).[52] Një faqe *opus mixtum* e ndërtesës, e cila shihet në seksionin e një kuadrati, shënon pjesën e pasme të një godine përballë anës lindore të forumit. Kjo do të thotë se gjatësia (L/P) e dyshemesë është me përafërsi 52-61 m.

Gërmimet e vitit 1977 në afërsi të kësaj zone nxorrën në dritë një mbishkrim për nder të Germanikusit, në vitin 12 m.Kr., kur ai u bë *duovir quinquennal* i qytetit;[53] mbishkrimi mund t'i përkiste një monumenti që ndodhej në skajin lindor të forumit. Gërmimet zbuluan dy bazamente statujash të vendosura direkt mbi dyshemenë e forumit. Në zonën VI, një podium i madh me gjatësi 4.5 m dhe lartësi 2.1 m, i ndërtuar me tulla, ndoshta mund të ketë shërbyer si support

[46] Mbi lidhjen mes bamirësive perandorake dhe akuaduktеve shih: Coulton 1987: 72-84. Mbi akuaduktin e Butrintit shih: Budina 1967: 145-52; Çondi 2000: 211-22. Gërmimet e fundit në fushë Vrinë i datojnë themelet e njërës prej këmbëve të akuaduktit në periudhën e Augustit.
[47] Këmbët e akuaduktit që vinin nga nymfeu në drejtim të qytetit duken të jenë të një faze më të vonë sesa ato që vinin nga fushë Vrina drej nymfeut. Falenderojmë A.I. Wilson për këtë vëzhgim si edhe për studimin e akuaduktit.
[48] Çondi 2000: 217.
[49] Hernandez 2007: 94-7.
[50] Zachos 2007: 285, 293-5. Datimi i akuaduktit të Nikopojës nuk është i sigurtë (fillimisht mendohej se ishte ngritur gjatë ndërtimit të qytetit nga Augusti; së fundi është propozuar një datim në periudhën e Hadrianit shih: Doukellis *et al.* 1995: 232-3; Zachos 2007: 273-95).
[51] Bescoby 2007: 112-3; Crowson dhe Gilkes 2007: 121-8.
[52] Për një raport paraprak mbi këto gërmime shih: Ceka 2006: 177-85.
[53] Pollo 1988: 213-5; Deniaux 2007: 35.

për një grup statujash honorifike. Në zonën XV, një podium më i vogël mermeri punuar hollë (me gjatësi 1.87 m, gjerësi 1.6 m dhe lartësi 0.47 m) mund të ketë shërbyer si bazament për një mbishkrim ose për një statujë.

Dëshmia më e mirë për ndërtimin e dyshemesë së forumit vjen nga datimi i shkallëve perëndimore dhe i një ulluku që përshkon dhomën 3 në drejtim të forumit (shih më poshtë). Kjo e dhënë e daton dyshemenë e forumit dhe rimodelimin në shkallë të gjerë të qendrës urbane në periudhën e Augustit. Planimetria themelore, një hapësirë katërkëndore e veshur me dysheme dhe një kanal kullues të integruar, e kufizuar nga dy shkallë dhe një portik, është pothuajse e njëjtë me atë të tregut romak në Korinth dhe të agorasë romake në Athinë.[54]

Fig. 9 Dyshemeja e forumit me shkallët që të cojnë në ndërtesën dy-katëshe (zona VI) (Butrint Foundation)

Ndërtesa me tre ambiente

(a) Ndërtesa 1.B (fundi i shek. I p.Kr. ose periudha e Augustit) (Fig.10)

Prishja e stoas veriore (Ndërtesa 1.A) i parapriu ndërtimit në *opus incertum* të Ndërtesës me 3 ambiente (1.B). Kjo e fundit (me përmasa 22.7 x 11.4 m) ishte e ndarë në 3 dhoma ku në secilën prej tyre hyhej nëpërmjet dyerve qendrore, të cilat qëndronin përballë një portiku që të çonte në forum. Një sipërfaqe pune për ndërtimin e Ndërtesës 1.B dha ndër të tjera, përveç gjurmëve të punimit të gurit dhe metalit, një hajmali argjendi *caduceus* dhe një fragment koke terrakotë, e cila ndoshta lidhet me Bakun. Në dhomën 3 një ulluk, uji i të cilit rridhte nga një e çarë në themelet e murit jugor, tregon se këta të dy i përkisnin të njëjtës kohë. Ulluku përfundon në shkallën e parë të mermerit, ku uji derdhej në kanalin e forumit. Ky ulluk është një e dhënë thelbësore që lidh Ndërtesën 1.B, portikun dhe dy shkallët e tij të mermerta, si edhe

[54] Scranton 1951: 180-94, e daton tregun romak të Korinthit në gjysmën e parë të shek. I m.Kr. Ndërtimi i agorasë romake në Athinë u fillua nga Çezari dhe u përfundua nga Augusti: Hoff 1988: 95-124. Sikurse Butrinti, edhe Korinthi priti një koloni të ardhurish italianë që nuk ishin veteranë: Hodges dhe Hansen 2007: 6.



Fig. 10 Planimetria e kompleksit të Ndërtesës me tre ambiente në kohën e Augustit (Butrint Foundation)

dyshemenë e forumit me të njëjtin program ndërtimi. Depozitat ndërtuese përmbanin qeramikë helenistike dhe romake (republikane të vonë), ku më e vona datonte në gjysmën e shek. I p.Kr. Nga depozitat e ndërtimit u zbuluan njëzet e nëntë monedha (27 helenistike; 1 që daton ndërmjet viteve 44-20 p.Kr.; 1 e periudhës së Augustit). Të dhënat sugjerojnë se Ndërtesa 1.B, portiku, dy shkallët dhe dyshemeja e forumit i përkasin periudhës së sundimit të Augustit.

Megjithëse funksioni i Ndërtesës me 3 ambiente mbetet i panjohur, disa të dhëna na shtyjnë të mendojmë se të tre dhomat ishin tempuj romakë. Gërmimet e mëparshme kanë zbuluar një mbishkrim, në dyshemenë antike të vonë ose mesjetare të dhomës 2, i cili është ripërdorur si *spolia*. Mbishkrimi përkujton ndërtimin e një *aedes,* dedikuar Minerva Augustas nga M. Otacilius Mystes me një dekret të dekurionit. J.R. Patterson, i cili e daton mbishkrimin në periudhën e Augustit ose në fillim të shek. I m.Kr., i referohet aprovimit të këshillit të qytetit si dëshmi që tregon se godina ishte publike dhe jo private.[55] Fazat e mëvonshme të Ndërtesës me 3 ambiente përfshinin bazamente statujash të vendosur në qendër të dhomës 2 dhe 3. Arkitektura ekzistuese e dhomave, përmasat e mbishkrimit dhe referenca ndaj një tempulli publik, si edhe prania e bazamenteve të statujave tregojnë se ka shumë mundësi që mbishkrimi fillimisht të ketë qenë pjesë e kësaj godine, e cila mund të ketë funksionuar si *Capitolium* i kolonisë, dedikuar Jupiterit, Junos dhe Minervës.[56]

(b) Ndërtesa 1.C (periudha e Hadrianit) (Fig. 9 dhe 11)

Një rimodelim i konsiderueshëm zmadhoi dhe lartësoi Ndërtesën me 3 ambiente. Duke ndjekur instalimin e tre shkallëve të tjera shtesë, pesë shkallë prej guri të latuar përgjatë anës veriore të dyshemesë së forumit të ngjisnin në portikun e Ndërtesës 1.C. Pjesë të një paradhome të ndërtuar me tulla u zbuluan *in situ* mbi shkallën e pestë. Në dhomën 1 u gjet një fragment qelqi gdhendur me reliev. Kjo gjetje tepër e rrallë ndoshta vinte nga Roma dhe daton diku nga fundi i shek. I p.Kr./mesit të shek. I m.Kr. Zbukurimet e brendshme të ndërtesës

[55] Patterson 2007: 41.
[56] Martin 2004: 86-7.



Fig. 11 Planimetria e kompleksit të Ndërtesës me tre ambiente në kohën e Hadrianit (Butrint Foundation)

përfshinin pikturat e mureve si dhe veshjen e tyre me mermer. Depozitat ndërtuese përmbanin 23 monedha: 11 helenistike (njëra prej të cilave ishte një imitim i një tipi të argjendtë, të prerë në kohën e Aleksandrit, e ndarë në dysh në antikitet, si duket pasi u kuptua se ishte falsifikim); 4 të periudhës republikane romake; 1 e periudhës Augustiane; 1 e Neronit; 1 e Trajanit; 2 të Hadrianit; dhe 3 të palexueshme. Qeramika, e cila në pjesën më të madhe i takon mesit të shek. I dhe fillimit të shek. II m.Kr., sugjeron se Ndërtesa 1.C i përket periudhës së Hadrianit.

(c) Ndërtesa 1.D (fundi i shek. II m.Kr) (Fig. 12)

Ndërtesa 1.D, në *opus incertum,* shënon një rindërtim në shkallë të gjerë. Një strukturë e thellë katërkëndore ndërtuar me llaç në dhomën 1 duket se ka shërbyer si themel për një kolonë të brendshme. Depozitat ndërtuese dhanë 3 monedha (përkatësisht të Hadrianit, Antoninit dhe një të palexueshme), të cilat japin vitin 138 m.Kr. një *terminus post quem*. Qeramika e daton Ndërtesën 1.D në fund të shek. II m.Kr.

(d) Ndërtesa 1.E (mesi i shek. III m.Kr.) (Fig. 13)

Faza finale e rindërtimit karakterizohet nga një teknikë ndërtimi e pazakontë në *opus incertum,* ku qoshet janë veshur me gurë të rregullt. Ajo përfshiu prishjen e të gjithë murit ballor të Ndërtesës 1.D, i cili u rrëzua në drejtim të jugut në zonën e portikut, pasi dyshemeja e këtij të fundit ishte zhveshur (seksioni verior në zonën X përmban një segment prej 11.3 m nga ky mur i rrëzuar). Një gropë eliptike, në dhomën 1, me shenja djegie në buzët e saj si pasojë e një zjarri, i cili mund të jetë përdorur për një kohë të gjatë, ndoshta kishte shërbyer si një furrë gëlqereje për ndërtimin e Ndërtesës 1.E. Ndërtesa kishte tavan të zbukuruar me motive floreale të gërshetuara. Një fragment qelqi i çmuar (2 x 1cm) në të cilin ishte gdhendur një femër, e cila qëndronte në këmbë gjysmë lakuriq, ndoshta Venusi, u gjet në dhomën 1. Depozitat ndërtuese përmbanin fragmente LRA3 të J. A. Riley-it, të importuara nga Azia e Vogël në mesin e shek. III m.Kr. dhe 9 monedha (4 helenistike, 1 e Augustit, 1 e Neronit, 1 e Otos, dhe 2 të Hadrianit). Qeramika varion nga mesi shek. II e deri në fillim/mesin e shek. III m.Kr. duke e datuar kështu Ndërtesën 1.E në mesin e shek. III m.Kr.



Fig. 12 Planimetria e kompleksit të Ndërtesës me tre ambiente në fund të shek. II m.Kr. (Butrint Foundation)



Fig. 13 Planimetria e kompleksit të Ndërtesës me tre ambiente në mesin e shek. III m.Kr. (Butrint Foundation)

Ndërtesa 5, një ndërtesë 2 katëshe (periudha e Hadrianit) (Fig. 8-9 dhe 11)

Ngjitur me Ndërtesën me 3 ambiente, dy dhoma me qemer në *opus vittatum* funksionojnë si një nënstrukturë, themel, për një godinë dy-katëshe (Ndërtesa 5). Shtatë shkallë të tjera shtesë, që të ngjisin në të, u gjetën përtej shkallës së pestë të forumit. Niveli i sipërm i ndërtesës u ngrit rreth 7 m mbi nivelin e forumit dhe fillimisht ngjitja në të realizohej nga 22 shkallë që nisnin nga dyshemeja e forumit. Ndërtimi i shkallëve mund të lidhet me ndërtimin e Ndërtesës 1.C në periudhën e sundimit të Hadrianit. Ndërtesa 5 duhet të ketë qenë struktura që binte më shumë në sy në qendrën urbane dhe ndoshta duhet të ketë formuar epiqendrën arkitekturore dhe pamore të forumit. Ne mendojmë se ajo ka funksionuar si tempull i ndonjë kulti perandorak, i vendosur përballë hyrjes qendrore jugore të forumit.[57]

Ndërtesa 2.B, rruga dhe shkallët perëndimore të forumit (Fig.5-6 dhe 8)

Stoa jugore (Ndërtesa 2.A) u rimodelua gjerësisht dhe u përfshi në anën J/JP të forumit (zona XV). Pjesa perëndimore e stoas jugore u kufizua dhe shkallët e saj prej mermeri midis dy kolonave (A dhe B) u zhvendosën për të ndërtuar një hyrje për një rrugë të re përgjatë anës perëndimore të forumit. Një bazament shtylle prej mermeri të bardhë, i gjetur *in situ*, mund të ketë shërbyer për të mbajtur një hark (me gjerësi 1.3 m) në forum; meqënëse gjerësia e rrugës është 3 m, ndoshta ky hark mund të ketë qenë i dyfishtë. Hapja e një kanali në shkallën e dytë, pranë kolonës C, përbënte fundin e kanalit (1) për Ndërtesën 2.B. Qeramika me datimin më të vonë, e gjetur në depozitën e ndërtimit të kanalit (1), i takon periudhës së Augustit.

Pjesa perëndimore e forumit përbëhet nga dy shkallë blloqesh gëlqerorë të bardhë. Mbetjet e kolonave me tulla të zbukuruara me stuko të pikturuar dëshmojnë se një kolonadë qëndronte mbi shkallën e dytë. Qeramika e gjetur në depozitën mbushëse poshtë dy shkallëve të anës perëndimore të forumit tregon një datim të periudhës së Augustit. Forma dhe funksioni i Ndërtesës 2.B mbeten të paqarta. Po të gjykojmë nga një kanal (2) i mëvonshëm dhe një dysheme *cocciopesto*, shkallët jugore duket se të çojnë drejt portikut të Ndërtesës 2.B. Kështu që ne ngremë hipotezën se kjo ndërtesë shtrihet në jug të kuadratit të gërmuar.

Burimi i shenjtë, dhoma trekëndore dhe shkallët drejt akropolit (Fig. 7-8 dhe 10-11)

Rruga, e cila shtrihej paralel me anën perëndimore të forumit, të çonte në burimin e shenjtë si edhe në shkallët drejt akropolit. Hyrja për në akropol dëshmohet nga prania e një porte në murin fortifikues rrethues, e vendosur mbi shkallët.[58] Dhoma trekëndore, e cila është e njëkohshme me Ndërtesën 1.B, kishte një platformë prej tjegullash dhe materialesh të djegura, të cilët ndoshta tregojnë se ajo ka funksionuar si një faltore e vogël pranë burimit. Ndryshimet e mëvonshme në dhomën trekëndore në fund të shek.I ose në fillim të shek. II m.Kr. përfshinë rimodelimin e shkallëve të sipërme në drejtim të akropolit si dhe shtrimin e një dyshemeje prej guri, e cila ndoshta mbante imazhin e një kulti.

Ndërtesa me peristil, Ndërtesa 4 (mesi shek. III m.Kr) (Fig. 13)

Në zonën XII, një dhomë e madhe (10.3 x 12.4 m) u ndërtua në *opus mixtum* si një shtesë e pandarë e ndërtesës me peristil. Një ulluk shtrihej nga kjo dhomë drejt kanalit të forumit. Si pjesë e re e fundit verior të rrugës, ndërtesa bllokonte rrugën që të çonte tek burimi i shenjtë, tek i cili tashmë duket se shkohej vetëm duke u nisur nga ndërtesa me peristil. Nisur nga përmasat dhe vendndodhja e saj në forum, dhoma e madhe mund të ketë shërbyer si *curia* për asamblenë zyrtare. Qeramika e gjetur e daton ndërtesën në mesin e shek. III m.Kr.

[57] Stili i muraturës së Ndërtesës 5 është i njëjtë me atë të *scanea frons* të teatrit. Kjo mund të sugjerojë se scanea frons dhe rindërtimi i teatrit mund ti përkasin periudhës së Hadrianit.
[58] Planimetria tek Bowden *et al.* 2002: 200, fig. 2, tregon pozicionin e portës, në veri të ndërtesës me tre ambiente.

Përdorimi i *spolia*-s dhe shkatërrimi i statujave (faza 1: vitet 230-250 m.Kr;faza 2: shek. X/XI)

Gërmimet nxorrën në pah dy faza gjatë të cilave statujat ishin shkatërruar. Faza e parë ka ndodhur gjatë zhveshjes dhe shkatërrimit të Ndërtesës 1.D, para ngritjes së Ndërtesës 1.E. Të dhënat arkeologjike flasin për një përpjekje sistematike për të prishur dhe hedhur tej statujat dhe mbishkrimet. Në zonën IX një sasi e madhe materiali ishte hedhur në kanalin helenistik, i cili e kishte humbur tashmë funksionin e tij, në vitet 230-250 m.Kr.[59] Materiali i hedhur përfshinte ndër të tjera dhe një statujë me përmasa njerëzore të zbuluar në vitin 2005 (Fig. 13-14). Datuar në mesin e shek. II m.Kr. ajo paraqet një zyrtar lokal të rangut të lartë ose një perandor që mban veshur një toga të stilit perandorak dhe këpucë patrici.[60] Fragmente të tjera skulpturore përfshijnë një fragment të një bazamenti statuje si dhe një copë të shkëputur të një këmbe. Tetë mbishkrime të fragmentuara dhe mbi një ton me qeramika u rizbuluan në këtë hedhurinë. Materiali është hedhur përpara ndërtimit të Ndërtesës 4 dhe ndoshta ishte pjesë e të njëjtit program ndërtimi. Meqë një ulluk në Ndërtesën 4 lidhej me kanalin kullues të forumit, ky i fundit ishte ende në përdorim kur flakeshin statujat. Një fragment krahu prej mermeri u zbulua nën murin ballor të Ndërtesës 1.D, i cili ishte hedhur mbi portikun tashmë të plaçkitur. E njëjta depozitë përmbante fragmente të tjera skulpturash, mbishkrime të fragmentuara dhe mermerë arkitektonikë. Qeramika e kësaj depozite daton në mesin e shek. III m.Kr. Gjithashtu këto depozita shkatërrimi përmbanin dhe një mbishkrim honorifik me shkronjat 'TPOM' që i referohen T. Pomponit, një anëtar i fisit të Atikut. Gropa e madhe e gërmuar në dhomën 1 mund të ketë qenë një gropë gëlqereje që ka funksionuar gjatë kësaj faze plaçkitjeje. Për momentin mbetet ende e paqartë nëse shkatërrimi i statujave ishte pasojë e një fatkeqësie natyrore (si p.sh një tërmet) apo rezultat i një sërë faktorëve socio-politikë.

Statujat romake u prishën në një fazë të dytë gjatë rilindjes mesjetare të qytetit në fundin e shek. X-XI. Pjesë e një statuje romake madhështore prej mermeri, ndoshta e Augustit, u zbulua në forum në vitin 2002.[61] Fragmente të tjera skulpture, si kokë, krahë, pjesë këmbësh, si edhe një bazament për një statujë prej bronzi u gjetën në depoziat e tjera të hedhurinave dhe të strukturave të mureve të përdorur si *spolia*, të cilat lidhen me ndërtimin e banesave mbi tarraca të shkallëzuara.[62]

Fig. 14 Statujë togati in situ (mesi i shek. II m.Kr.) (zona IX) (Butrint Foundation foto nga M. Grayley)

[59] Mbi materialin qeramik shih: Reynolds, Hernandez dhe Çondi 2008.
[60] Pojani 2007: 64. Falenderojmë I.L. Hansen për interpretimin e kësaj statuje.
[61] Pojani 2007: 62-77.
[62] R. Hodges e identifikon këtë program tarracues në sekuencat mesjetare.

Fundi i forumit romak (mesi/fundi i shek. IV m.Kr.)

Një depozitë me hedhurina, pjesë mermeresh zbukurues dhe fragmentesh arkitekturore mbulonte dyshemenë e forumit. Qeramika më e vonë e kësaj depozite daton në shek. IV m.Kr. Mbi të, një depozitë e dytë tepër kompakte, e përbërë nga një numër i madh hedhurinash nga shkatërrimi dhe mbetje materialesh ndërtimi, duket se ishte hedhur me qëllim mbi forum. Edhe këtu qeramika më e vonë daton në shek. IV m.Kr. Këto dy depozita janë pak a shumë të njëkohshme; e para përfaqëson plaçkitjen dhe rrëzimin e godinave që rrethonin forumin; e dyta një mbushje të forumit me hedhurina materialesh ndërtimi për të ngritur nivelin ekzistues të hapësirës.

Dyshemeja e sheshit të forumit përmban tashmë një pjerrësi me një këndprej 17 gradë; dyshemeja e anës jugore është rreth 0.6 m më e ulët se ajo e anës veriore. Ulluku 1, i cili derdhte ujin e Ndërtesës 2.B në kanalin e forumit tregon se kjo pjerrësi nuk kishte qenë një karakteristikë fillestare e forumit dhe duhet të ishte krijuar si pasojë e aktivitetit sizmik apo rrëshqitjes. Dyshemeja e sheshit të forumit është rreth 1 m nën nivelin e sotëm të ujit. Qendra urbane e Butrintit, sikurse qytetet e tjera bregdetare të Epirit, në mënyrë të qartë përjetuan një rritje të konsiderueshme të nivelit të detit.[63] Depozita të njëjta *spolia* dhe hedhurina materiale ndërtimi të shek. IV m.Kr. janë gjetur edhe nga gërmime të tjera në Butrint (p.sh pallati trikonkë) apo në vendbanimin e fushë Vrinës,[64] ku kërkimet e fundit në të kanë demonstruar se akuadukti në Butrint doli jashtë përdorimit në shek. IV m.Kr.[65] Sipas Libanius-it, një tërmet shkatërroi Greqinë në kohën e sundimit të Julianit (361-363), një ngjarje kjo që mund të ketë qenë e njëjtë me 'dallgën e detit', e cila sipas Cedrenus-it kishte shkretuar Epirin gjatë sundimit të Gratianit (375-383).[66] Burimet gjithashtu dëshmojnë për një tërmet dhe tsunami të vitit 365 m.Kr. që shkaktoi dëme të mëdha në të gjithë Ballkanin.[67] Një tërmet në gjysmën e dytë të shek. IV m.Kr. mund të ketë sjellë një ndryshim tektonik në Butrint që rezultoi me një përmbytje të forumit dhe të qendrës urbane përreth tij.[68] Kjo mund të spjegojë faktin se përse qendra qytetare u zhvendos në anën lindore të Butrintit gjatë periudhës së antikitetit të vonë, përreth zonës së Bazilikës së Madhe, ku terreni mbeti mbi nivelin e ujit. Fazat e plaçkitjes dhe shkatërrimit të forumit u pasuan nga mbushja e hapësirës së tij me synimin për të krijuar një sipërfaqe të re më të lartë. Në shek. V m.Kr. dysheme të forta e rezistente ndaj ujit, *cocciopesto,* u shtruan mbi hapësirën që më parë kishte qenë forum, për të parandaluar depërtimin e ujit gjatë përmbytjeve stinore. Gjithësesi, niveli i ujit vazhdoi të rritej, duke korresponduar dhe ndoshta duke përshpejtuar braktisjen e qendrës urbane në shek. VII m.Kr.[69] Një depozitë e trashë dhe relativisht e varfër lymore konfirmon se qendra urbane gjendej pjesërisht e zhytur në një kënetë të cekët deri në kohën kur u ndërmor programi i madh tarracues në shekujt X dhe XI. Banimi në zonën e forumit vazhdoi deri sa Butrinti u braktis nga venecianët në 1572.[70]

****

Ky projekt u financua nga Fondacioni Butrinti në partneritet me Institutin Pakard për Shkencat Humane (Packard Humanities Institute), të cilëve u jemi mirënjohës për mbështetjen e madhe. I jemi gjithashtu mirënjohës R. Hodges, i cili si drejtor i përgjithshëm i projektit, në bashkëpunim me I. Gjipalin, Instituti i Arkeologjisë, dhanë ndihmesë dhe këshilla shumë të

[63] Hammond 1967: 42, 47, 109, 127, 133; Ugolini 1935: 93.
[64] Crowson dhe Gilkes 2004: 122; Gilkes dhe Lako 2004: 155-67, fig. 9.5; Gilkes *et al.* 2007: 222-6. Një tërmet në fund të shek. IV m.Kr. mund të spjegojë transformimet kryesore të *domus*-it të shek. IV m.Kr. në pallatin trikonkë në fillim të shek. V m.Kr., një rindërtim që përdor në masë *spolia*.
[65] Crowson dhe Gilkes 2004: 122. Dalja jashtë përdorimi i akuaduktit është rikonfirmuar dhe nga gërmimet e fundit.
[66] Hodges *et al.* 1997: 217; Guidoboni 1994: 261-7.
[67] Hodges *et al.* 1997: 217; Kelly 2004: 141-67. Theofani dhe Murgu Gjergj, rrëfimet e të cilëve vijnë nga i njëjti burim, rendisin Adriatikun dhe Epirin, respektivisht, si zona të shkatërruara nga tsunami.
[68] Pavlides dhe Caputo 2004: 159-88, argumentojnë se Butrinti ishte epiqendra e një tërmeti të fuqishëm në vitin 358 m.Kr. Falenderojmë D. Bescoby për këtë reference.
[69] Gjashtë varre të gërmuar në sit shënojnë braktisjen e zonës në mesin e shek. VI/fillimin e shek.VII m.Kr. Këto varre lidhen me ato që janë gërmuar në pallatin trikonkë, shih: Bowden, Hodges dhe Lako 2002: 209; Gilkes dhe Lako 2004: 170-2.
[70] Hodges 2004: 14; Crowson 2007: 15-7.

vlefshme. Falenderojmë sinqerisht të gjithë anëtarët e projektit, të dhënat e të cilëve janë përdorur në këtë raport: qeramika nga Paul Reynolds (Universitat de Barcelona); monedhat nga Sam Moorhead, R. Abdy (British Museum) dhe Sh. Gjongecaj (Instituti i Arkeologjisë); qelqet nga S. Jennings (English Heritage); fauna nga A. Powell (University of Cardif); kockat dhe skeletet nga T. Fenton dhe J. Beatrice (Michigan State University); gjeoarkeologjia nga D. Bescoby (University of East Anglia). Falenderojmë D. Boschi, P. Crawley, A. Crowson, O. Gilkes, E. Glass dhe B. Hayden për asistencën në menaxhimin e gërmimeve. Puna dhe dedikimi i punëtorëve, studentëve shqiptarë dhe studentëve të huaj kontribuan në suksesin e projektit. Së fundi, falenderojmë R. Hodges, J.L. Davies dhe W. Bowden për komentet e bëra mbi një draft të mëparshëm të këtij raporti.

Bibliografi

Baçe, A. (1984), 'Vështrim mbi besimin dhe arkitekturën e kultit tek Ilirët', *Monumentet* 27.2, 5-32.

Bergemann, J. (1998), *Die römische Kolonie von Butrint und die Romanisierung Griechenlands*, München.

Bescoby, D. (2007), 'Geoarcheological investigation at Roman Butrint', në Hansen dhe Hodges (eds), 95-118.

Bowden, W. (2003), *Epirus Vetus: The Archeology of a late antique Province*, London.

Bowden, W., Hodges, R. dhe Lako, K. (2002), 'Roman and late-antique Butrint: excavations and survey 2000-1', *Journal of Roman Archeology* 15, 199-230.

Bowden, W. dhe Përzhita, L. (2004), 'Archeology in the landscape of Roman Epirus: preliminary report on the Diaporit excavations, 2002-3', *Journal of Roman Arhceology* 17, 413-33.

Bozhori, K. dhe Budina, D. (1966), 'Disa mbishkrime të pabotuara të Theatrit të Butrintit', *Studime historike* 20, 143-91.

Budina, Dh. (1967), 'Ujësjellësi i Butrintit', *Studime Historike* 2, 145-52.

Budina, Dh. (1988), 'Butrinti pararomak', në Budina, Dh., Drini, F. dhe Pollo, G. (eds), *Butroti*, Tiranë, 6-107.

Burnett, A., Amandry, M. dhe Ripollès, P.P. (1992), *Roman provincial coinage*, vol.1, London.

Cabanes, P. (1974), 'Les inscriptions du théâtre de Bouthrôtos', *Actes de colloque 1972 sur l'esclavage*, Ann. Litt. Besançon 163, 105-209.

Cabanes, P. (1976), 'L'Epire de la mort de Phyrros à la comquête romaine, 272-167 av. J.-C.', Ann. Litt. Besançon 186.

Cabanes, P (1996), 'États fédéraux et *koina* en Grèce du Nord et en Illyrie méridionale', në Cabanes, P. (ed), *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'antiquité* III, Paris, 373-82.

Cabanes, P. dhe Drini, F. (2007), *Etudes epigraphiques* 2. *Corpus des inscriptions grecques d'Illyrie méridionale et d'Épire* 2. *Inscriptions de Bouthrôtos*, Paris.

Ceka, N. (2006), Recent excavations in Butrint (2004-5): notes on the growth of the ancient city centre', në Bejko, L. dhe Hodges, R. (eds), *New directions in Albanian archeology*, Tiranë, 177-85.

Çondi, Dh. (1990), 'Gërmimet arkeologjike të vitit 1990 Butrint', *Iliria* 21.2, 264-265.

Çondi, Dh. (2000), 'Ujësjellësi i Butrintit', *Iliria* 1-2, 211-22.

Coulton, J.J. (1987), 'Roman aqueducts in Asia Minor', në Macready, S. dhe Thompson, F.H. (eds), *Roman architecture in the Greek world*, London, 72-84.

Crowson, A. (2007), *Ventian Butrint*, London.

Crowson, A. dhe Gilkes, O.J. (2007), 'The archeology of the Vrina plain: an assesement', në Hansen dhe Hodges (eds), 119-64.

Deniaux, E. (1975), 'Un exemple d'intervention politique: Cicéro et le dossier de Buthrote en 44 av. J.C.', *Bulletin de l'Association Guillaume Budé* 2, 283-96.

Deniaux, E. (1987), 'Atticus et l'Épire', në Cabanes, P. (ed), *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'antiquité* I, Adosa, 245-54.

Deniaux, E. (2007), 'La structure politique de la colonie romaine de Buthrotum', në Hansen dhe Hodges (eds), 33-9.

Doukellis, P., Dufaure, J. dhe Fouache, E. (1995), 'Le context géomorphologique et historique de l'aqueduc de Nicopolis', *BCH* 119, 209-33.

Drini, F. (1984), 'Sur la chronologie et les limites du koinon des Prasaiboi à la lumière des nouvelles données archéologiques', *Iliria* 14.2, 101-8.

Drini, F. dhe Budina, Dh. (1981), 'Mbishkrime të reja të zbuluara në Butrint', *Iliria* 11, 227-34.

Giannotti, G. (2005), 'Il teatro di Phoinike: materiali e stratigrafie per la cronologia delle fasi', në De Maria, S. dhe Gjongecaj, Sh. (eds), *Phoinike* III: *Rapporto preliminare sulle champagne di scavi e ricerche 2002-3*, Bologna, 82-7.

Gilkes, O.J. (ed) (2003), *The theater at Butrint: Luigi Maria Ugolini's excavations at Butrint 1928-1932*, London.

Gilkes, O.J. (2003a), 'Luigi Maria Ugolini and the Italian Mission to Albania', në Gilkes (ed), 3-21.

Gilkes, O.J. dhe Lako, K. (2004), 'Excavations at the triconch palace', në Hodges Bowden dhe Lako (eds), 151-75.

Gilkes, O.J. *et al*. (2007), 'Nicopolis and Butrint: the triconch palace and a possible model for late-antique housing in Epirot cities', në Zachos, K. (ed), *Νικοπλις Β*, Preveza, 219-30.

Giorgi, E., Vecchieti, E. dhe Bogdani, J. (eds) (2007), *Archeologia tra Pineco, Dalmazia ed Epiro*, Groma 1, Bologna.

Gravani, K. (2007), 'Ανασκαφικές μαρτυριές για το συνοικισμό Νικόπολη', në Zachos (ed), 101-22.

Guidoboni, E. (1994), *Catalogue of ancient earthquakes in the Mediterranean area up to the 10th century*, Rome.

Hammond, N.G.L. (1967), *Epirus: the geography, the ancient remains, the history and the topography of Epirus and adjacent areas*, Oxford.

Hansen, I.L. dhe Hodges, R. (2007), *Roman Butrint: An assessment*, Oxford.

Hernandez, D.R. (2007), 'Novità archeologiche da Butrinto: gli scavi al foro', në Giorgi, Vecchieti dhe Bogdani (eds), 93-8.

Hodges, R. (2004), 'Introduction', në Hodges, Bowden dhe Lako (eds), 1-19.

Hodges, R. (2006), *Eternal Butrint: An UNESCO World Heritage Site*, London.

Hodges, R. *et al*. (1997), 'Late-antique and Byzantine Butrint: interim report on the port and its hinterland (1994-95)', *Journal of Roman Archeology* 10, 207-34.

Hodges, R., Bowden, W. dhe Lako, K (eds) (2004), *Byzantine Butrint: Excavations and Survey 1994-99*, Oxford, Oxbow.

Hodges, R. dhe Hansen, I.L. (2007), 'Introduction', në Hansen dhe Hodges (eds), 1-16.

Hoff, M. (1988), *The Roman Agora at Athens*, Dizertacion doktorature.

Isager, J. (2001), 'Eremia in Epirus and the foundation of Nicopolis: models of civilization in Stabo', në Isager, J. (ed), *Foundation and destruction: Nicopolis and northwester Greece*, Athens, 7-26.

Kelly, G. (2004), 'Ammianus and the great tsunami', *Journal of Roman Archeology* 94, 141-67.

Martin, S. (2004), 'The topography of Butrint', në Hodges, Bowden dhe Lako (eds), 76-103.

Melfi, M. (2007), 'The sanctuary of Asclepius', në Hansen dhe Hodges (eds), 17-32.
Pani, G. (1988), 'Arkitektura e dy tempujve në Butrint dhe punimet restauruese në to', *Monumentet* 35.1, 23-37.
Pani, G. (2001), 'Sanktuari i Asklepit në Butrint', *Monumentet* 1992-99, 13-50.
Patterson, J.R. (2007), 'A dedication to Minerva Augusta from Butrint', në Hansen dhe Hodges (eds), 40-3.
Pavlides, S. dhe Caputo, R. (2004), 'Magnitude versus faults' surface parameters: quantitative relationships from the Aegean region', *Tectonophysics* 380, 159-88.
Pojani, I. (2007), 'The monumental togate statue from Butrint', në Hansen dhe Hodges (eds), 17-32.
Pollo, G. (1988), 'Një mbishkrim i Germanikut në Butrint', *Iliria* 1, 213-5.
Reynolds, P., Hernandez, D.R. dhe Çondi, Dh. (2008), 'Excavations in the Roman forum of *Buthrotum* (Butrint): 1st to 3rd century pottery assemblages and trade', *Acta Rei Cretariae Romanae Fautorum* 40, 71-88.
Riginos, G. (2007), 'Η Ρωμαιοκραία στα δυτικά παράλια της Ηπείρου με Βάση τα πρόσφατα αρχαιολογικά δεδομένα από τη Θεσπρωτία', në Zachos (ed), 163-73.
Rizakis, A.D. (1997), 'Roman colonies in the province of Achaia: territories, land and population', në Alcock, S. (ed), *The early Roman Empire in the East*, Oxford, 15-36.
Scranton, R. (1951), *Monuments in the Lower Agora and north of the Archaic Temple*, Corinth vol.1.III, Princeton, NJ.
Scullard, H.H. (1945), 'Charops and Roman policy in Epirus', *Journal of Roman Studies* 35, 58-64.
Ugolini, L.M. (1935), 'Il teatro di Butrinto', *RendPontAcc* 11, 82-93.
Ugolini, L.M. (1937), *Butrinto. Il mito d'Enea. Gli scavi*, Roma.
Ugolini, L.M. (1942), *L'acropoli di Butrinto*, Albania Antica III, Roma.
Ugolini, L.M (2003), 'Gli scavi del teatro', në Gilkes (ed), 73-106.
Villicich, R. (2005), 'Il teatro di Phoinike: nuove ricerche', në De Maria dhe Gjongecaj (eds), 67-9.
Villicich, R. (2007), 'Novità archeologiche da Phoinike: it teatro', në Giorgi, Vecchieti dhe Bogdani (eds), 70-2.
Wilkes, J.J. (2003), 'The Greek and Roman theatres of Butrint: a commentary and reassessment', në Gilkes (ed), 107-80.
Zachos, K. (2007), 'Η οχύρωση και η πολεοδομική οργάνωση της ρωμαϊκής Νικόπολης Νεότερα στοιχεία και παρατηρήσεις', në Zachos (ed), 273-98.
Ziolkowski, A. (1986), 'The plundering of Epirus in 167 B.C.: economic considerations', *Papers of British School at Rome* 54, 69-80.

Inge Lyse Hansen

Lidhja trojane: Butrinti dhe Roma*

"Ju të lumtun jeni, që sot e tutje s'keni pse me e drashtë fatin e paqëndrueshëm, ndërsa neve gjithnji po na përplas ndër dallgë të reja. Ju preheni n'qetsi, nevojë nuk keni me rrahë detin si na, dhe me kerkue Auzoninë, që kurrë me e kapë s'po e kapim. Ju jeni tue e pa Ksantin e ri edhe Trojën e re, që me duert tueja ndërtue e keni. Pastë një fat ma t'mirë e kurrë mos e provoftë furinë e grekve! N'arrifdha ndonjëherë atje në Tiber e n'ato fusha që përreth tij shtrihen, në pafsha me kto sy tue u ngrejtë krenare ledhet qe kombit tim i janë premtue, kam m'u përpjekë të baj çka asht e mundur, që dy qytetet motra dhe dy popujt, me t'njajtin gjak, që Epiri e Hesperia të cilët i bashkon një trung i vjetër, Dardani dhe të zezat e përbashkëta veç një atdhe të jenë për zemrat tona. Edhe kjo ndjenjë ndër nipa u trashigoftë!" [1]

Këto janë disa nga fjalët e lamtumirës që Enea i drejtoi Helenit, ndërsa qëndronte pranë anijeve të ankoruara jashtë mureve të Butrintit, gati të nisej drejt Italisë. Në versionin e historisë së Virgjilit, Enea së bashku me familjen dhe shokët e tij arrin të gjejë një qytet jo vetëm të sunduar nga Heleni dhe bashkëkombasit i tij trojanë, por të ndërtuar sipas imazhit të vetë Trojës: 'një Trojë e vogël, me një kopje të Pergamus-it të madh dhe një përrua të thatë që e merr emrin e tij nga Ksantosi (Xanthus)' dhe ndërsa hynte në qytet Enea mund të përqafonte portalet e portës Skea.[2] Si rrjedhojë, fjalimi i tij në praninë e Helenit nuk është thjesht një përshëndetje personale duke njohur pozitën e këtij parashikuesi, por i drejtohet të gjithë banorëve të Butrintit me një aluzion të një prejardhjeje të përbashkët. Në fakt, siç e bën të qartë edhe gjysma e fundit e fjalimit të tij, lamtumira e Eneas kthehet në një premtim të një lidhjeje trashëgimie më të madhe që u bëhet të gjithë banorëve të Epirit, përtej kohës dhe historisë.

* Ky artikull është një version i rishikuar i botimit në Hansen, I.L. dhe Hodges, R. (eds) (2007), *Roman Butrint: An Assessment*, Oxford, 'The Trojan Connection: Butrint and Rome', 44-61.

[1] Virgjili *Eneida*, III 694-715.
[2] Virgil *Aeneid* 3.349–51 (Loeb Classical Library 1999; përkth. H. Rushton Fairclough, rishikuar nga G.P. Goold). Nocioni i Butrintit si një imitim i Trojës është marrë gjithashtu dhe nga Ovid (*Metamorphoses* 13.715–17).